



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: Universiteti Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji

Pronari: Edmond HAJRIZI

OSHMA: Radio CAMPUS

Adresa: Lagjja Kalabria, p.n, Lipjan



VENDIM

për ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në regjionale, me seli në Komunën e
Lipjanit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Campus është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios në gjuhën shqipe, me seli në komunën e Lipjanit. KPM, me vendimin e datës 25 mars 2015, i ka lëshuar licencën Radio Campus për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 9 gusht 2021, Radio Campus ka dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin kategorisë së licencës, për të kaluar nga kategoria lokale në kategorinë regjionale. Kërkesën e saj Radio Campus e ka kompletuar me dokumentacion me datën 28 shtator 2021.


Arsyetim

4. Radio Campus në kërkesën e sajë ka deklaruar se arsye për ndryshimin e kategorisë së licencës, nga kategoria lokale në kategorinë regjionale është nevoja për informim të studentëve të Universitetit UBT.
5. Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (DMF)-së, në kuadër të Zyrës Ekzekutive, në aspektin teknik, ka vlerësuar se ndryshimi i kategorisë së licencës nga ajo lokale në regjionale është i mundshëm përmes ndryshimeve të parametrave teknik të licencës si rritja e fuqisë së transmetimit, ndryshimi i lartësisë së antenës ose/dhe ndryshimit të lokacionit të transmetuesit.

6. Komisioni konstaton se përveç ndryshimit të parametrave teknik të licencës, siç u përmenden më lartë në këtë rekomandim, lidhur me këtë ndryshim, nuk është e nevojshme frekuencë shtesë.
7. Lidhur me ndryshimin e kategorisë së licencës KPM, nuk ka të përcaktuara kritere specifike me Ligjin apo aktet nënligjore të KPM-së. Megjithatë, ky ndryshim nuk kërkon frekuencë shtesë e cila lëshohet vetëm përmes konkursit publik, mirëpo mund të bëhet me ndryshimin e parametrave teknike si: rritjen e fuqisë së transmetimit, rritjen e lartësisë së antenës apo edhe ndryshimin e lokacionit të saj brenda territorit të komunës për të cilën është licencuar. Gjithashtu, me këtë ndryshim pala obligohet të paguaj tarifë vjetore të licencës më të lartë, nga 350.00 euro për kategorinë lokale, të cilës i përket Radio Campus, në 700.00 euro për kategorinë regjionale. Në të kaluarën, KPM ka miratuar kërkesa për ndryshimin e kategorisë së licencës nga lokale në regjionale apo edhe të atyre nga lokale në kategori me fuqi të ulët të transmetimit.
8. Duke u bazuar në arsyetimin e kërkesës, Komisioni vlerëson se ndryshimi i kategorisë së licencës nga ajo lokale në atë regjionale, duke e rritur zonën e mbulueshmërisë së Radio Campus është në interes të publikut.
9. Komisioni vlerëson se, kërkesa për ndryshim të kategorisë së licencës është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

10. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 16 nëntor 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e kategorisë së licencës të Radio Campus, nga radio me mbulim lokal në radio me mbulim regjional, duke u bazuar në arsyetimin e cekur në kërkesë për këtë ndryshim. Ky ndryshim do të bëhet duke ndryshuar parametrat teknike të licencës, sipas rekomandimeve të Departamentit për Menagjimin e Frekuencave (DMF), në kuadër të Zyrës Ekzekutive të KPM-së.
11. Me ndryshimin e kategorisë së licencës së Radio Campus nga radio me mbulim lokal në radio me mbulim regjional, Radio Campus të obligohet që të paguaj tarifë vjetore të licencës për kategori regjionale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
12. Përveç ndryshimit të Pjesës II të licencës – Parametrave Teknik dhe pjesës IV të licencës – Zona e Mbulimit, respektivisht Harta e Zonës së Licencuar e Radio Campus, pjesët tjera të licencës mbeten të pa ndryshuara.
13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22.11.2021
datë